



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË

VENDIM
Nr 32 Datë 25.04.08

PËR
TRANSFERIM FONDI

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës për "TRANSFERIM FONDI", bazuar në ligjin nr. 8652 dt 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32, pika gj dhe n, të ligjit nr 9836, datë 27.11.2007, "Për buxhetin e shtetit të vitit 2008", të ligjit nr 8379, datë 29.07.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë", të V.K.M. nr 658, datë 10.10.2007 "Për kuotat financiare të ushqimit në mensat e konvikteve, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve dhe studentëve, në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2007-2008", të Udhezimit të Ministrisë së Financave nr 4, datë 17.01.2008 "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2008", si dhe të V.K.B. nr 2 datë 18.03.2008 "Mbi strukturën e administratës së bashkisë", mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë transferimin e fondit buxhetor pa ndryshuar destincionin e përdorimit të tij, nga Bashkia tek institucioni i Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, sipas tabelës së mëposhtme:

Qeverisja	Min e linjës	Institucioni	Emri i institucionit	Kapitulli	Kodi i qarkut	Programi	Llogaria ekonomike	Vlera
122	11	2122001	Bashkia	01	1515	09240	6020000	-11.000.000
122	11	2122017	N.SH.M.A. Ç	01	1515	09240	6020000	+11.000.000

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës e Bashkisë dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes,

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Këshillit

Raimonda NASE